

Emri i organizatës që jep komente: ELECTRIC MOBILITY LLC

Fushat kryesore të veprimit të organizatës: Mobiliteti elektrik dhe rrejtja e stacioneve për vetura elektrike në Kosovë

Data e dërgimit të komenteve: 11.06.2022

Kontributet:

	Çështjet kyçe	Komente rreth draftit aktual	Komente shtesë
1	Adoptimi i veturave elektrike në Kosovë	Drafti aktual i strategjisë i referohet Strategjisë së Transportit (në përgatitje) ku do të parashihen objektiva apo masa rreth adoptimit të veturave elektrike në Kosovë. Marrë parasysh implikimet e veturave elektrike në aspekt të nevojave infrastrukturore për stacionet e mbushjes së veturave elektrike, nga ato që instalohen në amvisëri (3-22kW) deri tek ato të shpejta me kapacitete deri në 360kW, kjo strategji do të duhej të ketë objektivë të vecant për vetura elektrike dhe infrastrukturën ndërlidhëse, me qëllim që të ofroj vizionin për infrastrukturë ligjore, masa dhe veprimet konkrete që do të duhej të ndërmerren.	<p>Të gjithë prodhuesit më të mëdhenjë të veturave, që dominojnë tregun Kosovar, janë zotuar se nga viti 2025 e tutje nuk do të kenë modele të veturave të reja me djegie të brendshme, si pasojë e standardit EURO7 që pritet të aprovohet gjatë vitit 2022 nga Parlamenti Europian dhe të hyj në fuqi në vitin 2025.</p> <p>Paralelisht të gjithë prodhuesit e veturave janë zotuar se deri në vitin 2030 do të ndalojnë plotësisht prodhimin e veturave me djegie të brendshme duke zëvendësuar ato plotësisht me vetura elektrike.</p>

		<p>Strategjia e Energjisë do të duhej të përcaktonte kornizën legislative dhe adaptimin e veturave elektrike në Kosovë. Korniza ligjore do të duhej të përcaktojë rolet e secilit aktorë të përfshirë në këtë sektor. Në ndërtimin e infrastrukturës së veturave dhe stacioneve elektrike do të duhej të përfshihen një sërë aktorësh, duke filluar nga operatorët elektrik, autoritetet publike, sektori privat (bizneset) dhe në fund konsumatorët.</p>	<p>Njëkohësisht, Parlamenti European vec se ka votuar propozimin për ndalim të qarkullimit të veturave me djegie të brendshme deri në vitin 2035, e cila pritet të aprovohet nga Këshilli i BE-së gjatë muajve në vijim.</p> <p>Të gjitha periudhat e sipërpërmendura janë brenda afateve të kësaj strategjie dhe se mungesa e objektivave dhe veprimeve konkrete në këtë strategji, nuk mundësojnë promovimin dhe adoptimin e veturave elektrike në Kosovë në periudhën e ardhshme 10 vjeçare, gjë që do të favorizonte importin e veturave të vjetra dhe ngritjen e importeve në vajra dhe derivate, si dhe ngritjen e ndotjes së ambientit.</p> <p>Prandaj, Kosova si me Strategjinë për Energji por edhe atë të Transportit do të duhej të parasheh objektiva specifike dhe veprime</p>
--	--	---	---

			<p>konkrete që synojnë adoptimin e veturave elektrike në Kosovë në formë graduale prej 5% deri në 50% të importit të veturave të reja deri në vitin 2030. Një gjë e tillë po ashtu do të ndikoj në bilancin energjetik, duke ulur importin e vajrave dhe derivateve.</p>
2	<p>Infrastruktura për stacione mbushëse për vetura elektrike në Kosovë</p>	<p>Drafti aktual i strategjisë i referohet Strategjisë së Transportit (në përgatitje) ku do të parashihen objektiva apo masa rreth adoptimit të veturave elektrike në Kosovë. Megjithatë, infrastruktura për të mundësuar instalimin e stacioneve të mbushjes për vetura elektrike nuk është subjekt i rregullimit apo planifikimit në Strategjinë e Transportit, por në atë të Energjisë.</p> <p>Prandaj, Strategjia e Energjisë në kuadër të një objektive specifike dhe veprimeve konkrete duhet të parasheh lehtësimin e procedurave por edhe mundësimin e ngritjes së kapaciteteve të</p>	<p>Veprimet konkrete të planifikuara në kuadër të strategjisë do të mund të rregullonin kapacitetet e ofruar për mbushje të veturave elektrike, lehtësonin apo reduktonin procedurat dhe kostot për qasje në kapacitete të nevojshme, përcaktimin e incentivave për shfrytëzim të kapaciteteve të lira gjatë periudhave jashtë pikut apo gjatë periudhave kur konsumi është më i ulët se prodhimi i energjisë në vend.</p> <p>Veprime të tilla do të përshejtonin shtrirjen e një rrjeti modern gradual të infrastrukturës për</p>

		<p>trafostacioneve, me procedurë të veçant për mbushësit e veturave elektrike në hapësira publike, me qëllim që të promovoj dhe mundësoj shtrirjen graduale të rrjetit të mbushësve të veturave elektrike në Kosovë, si parakusht për adoptimin në masë të veturave elektrike.</p>	<p>mbushje të veturave elektrike në Kosovë, gjë që mund të arrihet shumë më shpejtë se në vendet tjera të rajonit dhe BE-së për shkak të shtrirjes gjeografike dhe dendësisë së vendbanimeve.</p>
3	<p>Shfrytëzimi i teknologjisë V2G të veturave elektrike për balancim të rrjetit energjetik dhe ruajtjen/konzervimin e energjisë për kohë të pikut</p>	<p>Drafti aktual i strategjisë i referohet Strategjisë së Transportit (në përgatitje) ku do të parashihen objektiva apo masa rreth adoptimit të veturave elektrike në Kosovë. Megjithatë, veturat elektrike përmes stacioneve mbushëse në amvisëri, biznese apo hapësira publike paraqesin një mundësi ideale të ruajtjes/konzervimit të energjisë dhe shfrytëzimit të saj gjatë pikut.</p> <p>Kjo arrihet përmes teknologjisë Vehicle-to-Grid (V2G) që pothuajse të gjithë prodhuesit e veturave elektrike e përkrahin. Me masa konkrete dhe promovim të saj, mund të arrihet një efekt i jashtëzakonshëm në</p>	<p>Sipas tarifave aktuale, shfrytëzuesit potencial të veturave elektrike, për nevoja private apo të biznesit, janë të prirur që mbushjen ta bëjnë gjatë tarifës së lirë që është periudhë jashtë pikut.</p> <p>Shfrytëzueshmëria e veturave elektrike gjatë ditës sipas statistikave në BE janë rreth 55 minuta gjatë 24 orëve, gjë që është dukshëm më e ulët në Kosovë për shkak të distancave më të shkurta. Rrjedhimisht, periudha tjetër pasive gjatë ditës dhe periudhës së pikut mund të shfrytëzohet për të fut energjinë e konzervuar në vetura elektrike drejt rrjetit për</p>

		<p>konzervim të energjisë, ku kapacitetet mesatare të baterive të veturave elektrike janë rreth 55kW.</p>	<p>periudhë të pikut, me skema adekuate të promovimit të një veprimi të tillë.</p>
4	<p>Planifikimi për përdorim të dytë të baterive të veturave elektrike</p>	<p>Drafti aktual i strategjisë i referohet Strategjisë së Transportit (në përgatitje) ku do të parashihen objektiva apo masa rreth adoptimit të veturave elektrike në Kosovë. Megjithatë, veturat elektrike posedojnë potencial të jashtëzakonshëm në ripërdorimin e baterive të tyre (futjen në përdorim të dytë) pas humbjes së efikasitetit në vetura elektrike në një periudhë 6-8 vjeçare (në flota të bizneseve 3-5 vjet).</p>	<p>Nëse synohet që në 3 vitet e ardhshme Kosova të ketë adoptim deri në 20% të veturave elektrike nga gjithësejtë importi i veturave të reja, Kosova mund të ketë afro 1050 vetura elektrike me bateri mesatare prej 55kW. Në një periudhë 5-8 vjeçare këto vetura do të duhej të zëvendësonin bateritë e tyre nën 70% të kapacitetit, gjë që mund të ofronte gjithësejtë 34.6 MW kapacitet për konzervim të energjisë (e llogaritur në 60% aftësi të baterive).</p>
5	<p>Planifikim për masa konkrete të lehtësimit apo subvencionimit të veturave elektrike dhe stacioneve mbushëse</p>	<p>Drafti aktual i strategjisë i referohet Strategjisë së Transportit (në përgatitje) ku do të parashihen objektiva apo masa rreth adoptimit të veturave elektrike në Kosovë.</p> <p>Megjithatë, marrë parasysh që shumica e implikimeve infrastrukturore dhe</p>	<p>PRAKTIKAT E MIRA NË BE</p> <p>1. Veturat Elektrike për përdorim privat apo nevoja të biznesit</p> <p>1.a. Reduktim i plotë ose i pjesshëm të TVSH-së dhe taksave doganore</p>

		<p>përfitimeve të veturave elektrike biejnë në resorin e energjetikës, kjo Strategji do të duhej të parashih masa përkrahëse, promovuese dhe subvencion për vetura elektrike dhe instalimin e mbushësve të tyre.</p> <p>Kjo strategji duhet të promovoj lehtësime fiskale dhe doganore në importin e veturave elektrike dhe mbushësve të tyre, me qëllim të barazimit të çmimeve me veturat tjera konvencionale.</p> <p>Kosova, si vendi i vetëm në rajon dhe në BE pa lehtësime apo subvencione, duhet të ndjek shembullin e shteteve në rajon dhe BE, me lirim nga TVSH dhe taksave doganore për vetura elektrike dhe mbushësit, apo të ofroj skema të subvencionimit në vlera ekuivalente.</p>	<p>1.b. Skemë e subvencionimit e kombinuar me lirime fiskale</p> <p>1.c. Ulja e taksës së regjistrimit të veturave elektrike dhe hibride</p> <p>2. Stacionet Mbushëse për vetura elektrike dhe hibride</p> <p>2.a. Për përdorim privat (ekonomitë familjare) – Stacione me kapacitet deri në 22kW</p> <p>2.a.1. Largimi i plotë i TVSH-së</p> <p>2.a.2. Subvencionim i drejtpërdrejtë deri në 200 EUR për çdo njësi të instaluar</p> <p>2.b. Për përdorim kolektiv në njësi të banimit kolektiv (këshillat banesore ose ndërtuesit) – Stacione me kapacitet deri në 22kW</p> <p>2.b.1. Largimi i plotë i TVSH-së</p> <p>2.b.2. Subvencionim i drejtpërdrejtë deri në 200</p>
--	--	---	--

			<p>EUR për çdo njësi të instaluar me kusht të ofrimit të mbushjes për 25% të kapacitetit të garazhimit</p> <p>2.b.3. KEDS të siguroj kapacitete shtesë të nevojitura në trafostacione për çdo banim kolektiv pa pagesë shtesë</p> <p>2.c. Për përdorim publik (operatorë ekonomik të specializuar) - Stacione me kapacitet mbi 50kW</p> <p>2.c.1. Largimi i plotë i TVSH-së (pa efekt për shkak të TVSH-së së zbritshme)</p> <p>2.c.2. Subvencionim i drejtpërdrejtë deri në 10,000 EUR për çdo njësi të instaluar me kusht të ofrimit të mbushjes me tarifata e përcaktuara nga KESCO pa fitim për periudhë 12 mujore drejtë qytetarëve</p> <p>2.c.3. KEDS të siguroj kapacitetet shtesë të nevojitura në trafo stacione për çdo njësi të instaluar pa ngarkesë</p>
--	--	--	--

			shtesë qoftë në hapësirë publike ose private me qasje publike (si qendrat tregtare, parkingjet private, etj.)
--	--	--	---